

## Vendim nr. 30 datë 14.02.2024

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Elsa Toska, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahim, Marjana Semini, Sonila Bejtja, anëtarë, në datën 14.02.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 3 (P) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** PETRIT ALIAJ

**OBJEKTI:** Revokimi i urdhrimit të ekzekutimit të vendimit nr. 71, datë 05.04.2023 të Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

**BAZA LIGJORE:** Neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 616 i Kodit të Procedurës Civile (*KPC*); neni 1, pika 2, i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese (*Mbledhja e Gjyqtarëve*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

### V Ë R E N:

#### I

#### Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Petrit Aliaj në datën 21.09.2020 i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) për shfuqizimin e vendimeve të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën. Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 99, datë 16.11.2020, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, me arsyetimin se kërkuesi nuk legjitimohej *ratione temporis*, pasi kërkesa ishte paraqitur jashtë afatit ligjor 4-mujor.

2. Në vijim, kërkuesi i është drejtuar edhe 6 (gjashtë) herë të tjera Gjykatës, ku në kërkesën më të fundit që i përket datës 19.01.2023 ka kërkuar shfuqizimin e 6 (gjashtë) vendimeve të kolegjeve të Gjykatës, nr. 99, datë 16.11.2020, nr. 30, datë 12.03.2021, nr. 82, datë 01.06.2021, nr. 134, datë 01.12.2021, nr. 79, datë 06.07.2022 dhe nr. 120, datë 28.09.2022, si dhe të vendimeve nr. 198, datë 01.02.2013 dhe nr. 9, datë 27.05.2020 të Gjykatës së Lartë dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 6260, datë 13.07.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

3. Pas shqyrtimit paraprak, Mbledhja e Gjyqtarëve, bazuar në nenin 31/c të ligjit nr. 8577/2000 dhe nenit 20 të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese (*Rregullorja*), me vendimin nr. 71, datë 05.04.2023 (*vendimi nr. 71/2023*), ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, caktimin e gjobës në vlerën 100.000 (njëqind mijë) lekë ndaj kërkuesit dhe ka ngarkuar shërbimin përbarimor gjyqësor për ekzekutimin e gjobës për llogari të buxhetit të shtetit. Mbledhja e Gjyqtarëve ka evidentuar se kërkuesi ka paraqitur në mënyrë të përsëritur 7 herë kërkesa në Gjykatë (në datat 21.09.2020, 18.01.2021, 22.03.2021, 22.07.2021, 05.04.2022, 29.07.2022 dhe 19.01.2023), duke kundërshtuar të njëjtat vendime gjyqësore të gjykatave të zakonshme dhe, në thelb, edhe për të njëjtat shkaqe. Sipas saj, pavarësisht se kërkuesi është paralajmëruar disa herë dhe i është tërhequr vëmendja për vendosjen e gjobës, ai ka vijuar të paraqesë kërkesa të përsëritura dhe abuzive, me të njëjtin shkak dhe objekt, megjithëse janë shqyrtuar një herë nga Gjykata, çka përbën bazë të mjaftueshme për zbatimin e nenit 31/c të ligjit nr. 8577/2000 dhe të nenit 20, pika 2, shkronja “b”, të Rregullores. Në përfundim, Mbledhja e Gjyqtarëve ka konkluduar se kërkuesi i ka konsumuar të gjitha kushtet e parashikuara nga neni 31/c i ligjit nr. 8577/2000 dhe neni 20, pika 2, shkronja “b”, i Rregullores, për rrjedhojë ka urdhëruar gjobitjen e tij me vlerën minimale të parashikuar nga ligji (100.000 lekë) për t’i shërbyer në ndërgjegjësimin e ushtrimit të të drejtave në mënyrë efektive.

4. Pas dhënies së vendimit nr. 71/2023, Drejtoria e Përgjithshme e Përbarimit, Zyra Tiranë (*Zyra e Përbarimit Tiranë*) ka filluar procedurat për ekzekutimin vullnetar të urdhrit të ekzekutimit, i cili nuk është përmbushur nga kërkuesi. Pas kalimit të afateve ligjore, me vendimin e datës 14.11.2023, Zyra e Përbarimit Tiranë ka vendosur fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm dhe ka urdhëruar vënien në sekuestro konservative të llogarisë bankare në shumën 112.000 lekë dhe mbi pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme (në rast se ka) të kërkuesit.

5. Në datën 01.11.2023 kërkuesi i është drejtuar gjykatës civile me kërkesë për pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv ndaj vendimit nr. 71/2023 të Mbledhjes së Gjyqtarëve, bazuar në nenin 609 të KPC-së.

6. Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë, me vendimin nr. 6121, datë 20.11.2023, ka vendosur kthimin e akteve, me arsyetimin se kërkesa ka të meta thelbësore, të tilla që nuk mund të rregullohen gjatë procesit gjyqësor. Sipas gjykatës, kërkuesi ka paraqitur aktin formal “kërkesë”, ndërsa duhet të kishte paraqitur “kërkesëpadi” dhe për rrjedhojë çështja është regjistruar në regjistrat e gjykatës si “kërkesë”. Ai ka parapaguar si taksë regjistrimi tarifën për këtë formë, duke shprehur vullnetin për ta investuar gjykatën me kërkesë, si dhe nuk ka përcaktuar drejt ndërgjyqësinë se cili është subjekti ndaj të cilit kundërdrejtohet çështja. Në vijim, kërkuesi ka paraqitur sërish kërkesë pranë asaj gjykate për sqarimin dhe interpretimin e vendimit.

7. Në datën 19.01.2024 kërkuesi i është drejtuar sërish Gjykatës me kërkesë për revokimin e urdhrin të ekzekutimit të vendimit nr. 71/2023, mbështetur në nenin 616 të KPC-së. Kolegji i Gjykatës, bazuar në nenin 31, pika 3, të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve.

## II

### **Pretendimet e kërkuetit**

8. Kërkuesi, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se nuk ka shkelur asnjë nga kushtet e nenit 31/c të ligjit nr. 8577/2000 dhe të nenit 20 të Rregullores. Qëllimi që ai të tërhiqet nga paraqitja e pretendimeve për shkelje të pikave 2, 3 dhe 4 të nenit 31 të ligjit nr. 8577/2000 nuk do të realizohet, pasi ai nuk do të ndërpresë kërkesat me pretendime për shkaqe të ndryshme deri në marrjen e një vendimi përfundimtar të formës së prerë nga Gjykata. Ai është dakord që Gjykata të zbatojë pikën 2 të nenit 20 të Rregullores dhe të dërgojë materialet për hetim prokurorisë së Tiranës, pasi do të ishte lehtësim për të që gjobën ta shlyejë nëpërmjet punës që do t'i caktohet nga administrata e burgjeve. Sipas tij, nuk ka paraqitur kërkesë të njëjtë me atë të regjistruar në datën 21.09.2020 dhe për këtë ka prova.

## III

### **Vlerësimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve**

9. Mbledhja e Gjyqtarëve, fillimisht, evidenton se çdo individ, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

10. Neni 31/c, pika 3, i ligjit nr. 8577/2000 parashikon se gjoba e vendosur nga Gjykata është titull ekzekutiv dhe mjetet e mbrojtjes kundër ekzekutimit të vendimeve parashikohen në

KPC. Kjo do të thotë se kërkuesi ka mjete të tjera juridike në dispozicion për të mbrojtur interesat e tij ndaj urdhrit të ekzekutimit.

11. Në çështjen konkrete Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se me vendimin nr. 71/2023, ndër të tjera, ajo ka vendosur caktimin e gjobës ndaj kërkuesit në masën 100.000 lekë. Zyra e Përmbartimit Tiranë ka filluar procedurat ligjore për ekzekutimin e tij, duke lëshuar edhe urdhrat përkatëse, me qëllim vjeljen e gjobës. Në vijim, kërkuesi e ka kundërshtuar urdhrin e ekzekutimit në gjykatë, duke iu drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë me kërkesë për deklarimin të pavlefshëm të titullit ekzekutiv, bazuar në nenin 609 të KPC-së.

12. Po kështu, kërkuesi i është drejtuar edhe Gjykatës me kërkesë për revokimin e urdhrit të ekzekutimit të vendimit nr. 71/2023, duke kërkuar, në themel të argumenteve të tij, heqjen dorë të kreditorit nga ekzekutimi dhe pushimin e procedurës së ekzekutimit të detyrueshëm të vendimit, bazuar në nenin 616 të KPC-së. Ndërkohë, Mbledhja e Gjyqtarëve konstaton se kërkesa, në thelb, është me natyrë administrative, pasi kërkuesi i është drejtuar Gjykatës në cilësinë e kreditorit, me qëllim që ajo të veprojë administrativisht dhe jo për të ushtruar kontroll kushtetues për cenimin ose jo të një të drejte apo lirie themelore kushtetuese të tij.

13. Në këto rrethana, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se shqyrtimi i çështjes së paraqitur nga kërkuesi Petrit Aliaj nuk i përket juridiksionit kushtetues, por atij administrativ dhe, si i tillë, duhet trajtuar sipas ligjit nga strukturat administrative të Gjykatës.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Mbledhja e Gjyqtarëve, bazuar në nenet 31 dhe 31/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

### **V E N D O S I:**

1. Nxjerrjen jashtë juridiksionit kushtetues të çështjes së paraqitur nga kërkuesi Petrit Aliaj.
2. Shqyrtimin administrativ të çështjes së paraqitur nga kërkuesi Petrit Aliaj.